**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 01/27**
**Datë: 26.08.2020**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Master Plani për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie 2020-2021, i hartuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (bashkëngjitur këtij vendimi si Shtojca numër 1.)

2. Në pajtim me Vendimin e Qeverisë Nr. 01/23 për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, lidhur me masën 11 të Programit, për realizimin e vitit shkollor 2020/21 në kushte pandemie dhe në zbatim të masave të përcaktuara në Master Plan ndahen mjete financiare në shumë prej 9,926,959 euro për vitet 2020 dhe 2021.

3. Këto mjete ndahen sipas viteve:
   3.1. Për MASH do të ndahen 1,864,647 euro për vitin 2020 dhe 1,401,512 euro për vitin 2021.
   3.2. Për komuna ndahen 2,960,000 euro për vitin 2020 dhe 3,700,800 euro për vitin 2021.

4. Ndarja e mjeteve financiare për komuna bazohet në kriterin e numrit të nxënësve (bashkëngjitur këtij Vendimi si Shtojca numër 2.)

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe komunat e Republikës së Kosovës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

# *Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science*

## MASTER PLANI

## PËR ZHVILLIMIN E MËSIMIT NË KUSHTE PANDEMIE 2020-2021

## NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Prishtinë, gusht 2020

Përmbajtje


HYRJE ..... 5

Shpenzimet kryesore sipas skenareve: ..... 5

Konceptet kryesore ..... 6

Format e e-mësimit sipas niveleve dhe shërbimeve arsimore: ..... 6

QËLLIMI ..... 7

PARIMET ..... 8

VLERAT ..... 8

OBJEKTIVAT: ..... 8

PAKOT PUNUESE ..... 9

I. Komponenta e mësimit në distancë ..... 9

1. Koncepti i eMësimit dhe informimi ..... 9
2. Hartimi i vendimeve dhe udhëzuesve përkatës ..... 9
3. Hartimi i kurrikulës dhe orarit ..... 9
4. Përzgjedhja dhe aftësimi i mësimdhënësve për mësimin në distancë ..... 10
5. Sigurimi dhe organizimi i produksionit (Shkollat Qamil Batalli dhe Emin Duraku & Gracanice) 10
6. Zbatimi i mësimit në distancë - xhirimi i emisioneve ..... 11
7. Produksioni dhe transmetimi ..... 11
8. Monitorimi dhe vlerësimi ..... 11
9. Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (EHF) – edukimi në distancë ..... 12
10. Arsimi për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore – mësimi në distancë ..... 13

10a) Mirëmbajtja dhe popullimi i platformës arsimigjithperfshiers.net për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore ..... 13

10.b) Trajnimi i mësimdhënësve që punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta për përdorim të teknologjisë në mësimdhënie ..... 13

II. Komponenta e mësimit online ..... 14

11. Platforma e mësimit online: ..... 14

12. Aftësimi i mësimdhënësve: ..... 15

13. Sigurimi i pajisjeve teknologjike për zhvillimin e mësimit online ..... 15

13.a. Shkolla - qendër burimore për e-mësimin ..... 16

13b) Sigurimi i platformave për menaxhimin e zhvillimit online dhe në distancë ..... 16

III. Komponenta e punës praktike ..... 17

14. Planifikimi dhe zbatimi i punës praktike dhe i praktikës profesionale ..... 17
IV. Komponenta e zhvillimit të mësimit në shkollë ..... 17
MASTER PLANI – PER ZBATIMIN E MESIMIT NE DISTANCE 2020-2021 ..... 20
I. Komponenta e mësimit në distancë ..... 20
**II. Komponenta e mësimit online** ..... 22
III. Komponenta e praktikës profesionale ..... 22
IV. Komponenta e zhvillimit të mësimit në shkollë ..... 23
BUXHETI – KOSTIMI I AKTIVITETEVE ..... 24
KOSTOJA E KOMPONENTËS SË MËSIMIT NË DISTANCË ..... 24
**Tabela 1: Përllogaritja e kostos për organizimin e mësimit në distancë në gjuhën shqipe – KLASAT 1-9** ..... 24
**Tabela 2: Përllogaritja e shpenzimeve për mësimin online për komunitetet për klasat 1-9:** ..... 26
Tabela 3: Përllogaritje e shpenzimeve për zbatimin e mësimit në distancë për edukimin parashkollor ..... 28
Tabela 4. Përllogaritje e shpenzimeve për zbatimin e mësimit në distancë për ANV ..... 29
Komponenta 2: mësimi online ..... 29
Tabela 5: Kostimi i zbatimit të mësimit online ..... 29
Komponenta 3: puna praktike ..... 30
Tabela 6: Buxheti për komponentën e punës praktike në shkollat profesionale ..... 30
Komponenta 4: Zhvillimi i mësimit në shkollë ..... 31
Tabela 7: Buxheti për komponentën e mësimit në shkollë ..... 31
**Tabela 8. Buxheti përmbledhës për organizimin e e-mësimit (mësimi në distancë, mësimi online dhe praktika në shkolla)** ..... 32
Paraqitje tabelare e shpenzimeve të parapara në nivel qendror – MASH dhe në nivel vendor sipas viteve. ..... 33
Tabela 9. Shpenzimet e parapara dhe kërkesa për alokime për MASH nga Fondi i Rimëkëmbjes sipas viteve ..... 33
Tabela 10: SHpenzimet e parapara dhe alokime e kërkuara për nivelin vendor sipas viteve ..... 33
(shih tabelat e bashkelidhura ..... 33
Shtojca 1 ..... 34
Mënyra e përllogaritjes së kostos së realizimit të e-mësimit ..... 34
Mënyra e përllogaritjes për komunitetet: ..... 35
Shtojca 2: Përllogaritja e kostos së dezinfektimit të shkollës ..... 36
Kosto e platformës për një vit ..... 36

## HYRJE

Qëllimi i këtij dokumenti është që të pasqyrohet Projekti për fillimin e mësimit për vitin shkollor 2020 – 2021, me fokus në e-mësimin dhe mësimin në objektet shkollore, përfshirë një Plan të Veprimit dhe Koston e projektuar të përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të e-mësimit. Komponentat kryesore të e-mësimit në Kosovë janë:

(i) mësimi në distancë (RTK e YouTube) do të zbatohet (a) për klasat 1-9, (b) për edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH) dhe (c) për arsimin për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (ANV)

(ii) mësimi online (me Zoom, Google Meet / Classroom, dhe Microsoft Office) do të organizohet (a) tërësisht në shkollat e mesme të larta, dhe (b) pjesërisht për klasat 1-9, për EFH dhe ANV (krahas mësimit në distancë).

(iii) Mësimi praktik – praktika profesionale.

(iv) Zhvillimi i mësimit në objekte shkollore.

Fushëveprimi i këtij projekti është shumë i gjerë pasi që parasheh aspektet kryesore të fillimit të mësimit në objekte shkollore dhe zbatimin e e-mësimit në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar (edukimin në fëmijërinë e hershme, klasat 1-5, 6-9, dhe 10-12), arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta (ANV), dhe mësimin në gjuhët e komuniteteve (serbë, boshnjakë, turq, romë) në shkollat e Kosovës.

Rol kryesor në zbatimin e e-mësimit në Kosovë në vitin 2020 do të luajnë MASH, DKA, shkollat dhe komuniteti. Po ashtu përkrahje e rëndësishme pritet nga partnerët zhvillimorë si në rrafshin e ekpsertizës dhe në përkrahjen financiare.

### Shpenzimet kryesore sipas skenareve:

**Skenari A: mësimi zhvillohet në shkolla**

Kërkohet investim në pastërti, mirëmbajtje dhe dezinfektim të shkollës – **2,582,000 euro** (vlerësim në bazë të një praktike të mirë në Prizren).

Sigurimi i përkrahjes për DKA-të dhe shkollat për mbulimin e vëllimit të shtuar të punës si rezultat i riorganizimit të paraleleve për të siguruar distancën e duhur në mes të nxënësve; pos kësaj duhet siguruar përkrahje për ruajtjen e shëndetit të mësimdhënësve me gjendje të rënduar shëndetësore duke i zëvendësuar sa herë që kjo është e domosdoshme dhe e mundu; kushtet e pandemisë kërkojnë mobilizim të shtuar për mirëmbajtje (e llogaritur në rreth 100 norma të punëtorëve teknik /të mirëmbajtjes); njëkohësisht kërkohet përkrahje e shtuar psikologjike )baraz me 100 norma të psikologëve shkollor), pedagogë e të tjerë, me një kosto të gjithëmbarshme të shpenzimeve të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë në shumë prej **€ 4,444,200**

**Skenari B: mësimi i kombinuar (mësim në shkolla dhe mësim në distancë)**

Kërkohet investim në pastërti, mirëmbajtje dhe dezinfektim të shkollës – **2,582,000 euro** (vlerësim në bazë të një praktike të mirë në Prizren).

Përkrahja e shkollave për mbulimin e vëlimit të shtuar të punës dhe për zëvendësimin e mësimdhënësve me gjendje të rënduar shëndetësore (baraz me 1300 norma për të gjitha komunat), përkrahja në mirëmbajtje, shërbime psikologjike, pedagogjike e të tjera. – Gjithsej Kosto **€ 4,444,200**

Kërkohet po ashtu zhvillimi i mësimit online dhe në distancë: **€ 1,003,440** (MASH) **€ 337,790** (donatorë)

Kërkohet blerja e pajisjeve teknologjike në vlerë prej **1,100,000 euro**.

Platforma e e-mësimit vlerësohet në kosto prej rreth **€ 2,600,000**

**Skenari C: mësimi online dhe në distancë**

Kërkohet zhvillimi i mësimit online dhe në distancë: **€ 1,003,440** (MASH) **€ 337,790** (donatorë)

Kërkohet blerja e pajisjeve teknologjike në vlerë prej **1,100,000 euro**.

Platforma e-mësimit vlerësohet në kosto rreth **€ 2,600,000**

**Opcioni D: 180,000 euro** (opsion rezervë)

## Konceptet kryesore

Në vijim shpjegohen konceptet kryesore të cilat mund të jenë të reja për vendimmarrësit, opinionin publik, ose prindërit.

**e-Mësimi:** është çdo formë e mësimit (elektronik) që ka për bazë internetin si medium i shpërndarjes së informatës dhe për komunikim. Ky është koncepti më i gjerë i formave të mësimit të bazuar në internet dhe përfshinë format e tjera të shpjeguara në vijim.

**Mësimi online:** është mësimi dhe ndërveprimi i mësimdhënësit me nxënësin në kohë reale duke përdorur internetin ose forma të tjera të avancuara të komunikimit (platforma dhe aplikacione të ndryshme si zoom, google meet, google classroom, microsoft teams, e të tjera). Kjo formë e mësimit mundëson më shumë ndërveprim dhe komunikim dykahor ne mës të nxënësve dhe mësimdhënësve. Kjo formë e mësimit do të aplikohet në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë.

**Mësimi në distancë:** nënkupton forma të ndryshme të përgatitjes, hartimit dhe shpërndarjes së materialeve mësimore dhe të vlerësimit të dijes së nxënësit e të studentit. Kjo mund të realizohet nëpërmjet të formave më të ndryshme, si për shembull me televizion (mësimi në RTK gjatë pandemisë COVID 2020), në platforma si you-tube (mësimi gjatë Pandemisë COVID 19 në vitin 2020), me radio, me postë (formë paksa më e vjetruar por e përdorur gjerësisht gjatë shekullit 20) e të tjera.

**Mësimi i kombinuar (blended learning):** është formë e mësimit që kombinon elemente të e-mësimit por edhe të mësimit në objekte fizike me një pjesëmarrje relativisht të balancuar të të dyja formave të të mësuarit.

**Mësimi praktik** – të gjitha format e mësimit dhe lëndët profesionale për të cilat është e domosdoshme të realizohet edhe mësim praktik në shkollë, në laborator, në punëtori, ose në ndërmarrje / institucione. Një pjesë e mësimit praktik do të zhvillohet edhe në formë të mësimit të digjitalizuar.

## Format e e-mësimit sipas niveleve dhe shërbimeve arsimore:

Në vijim jepen format e ndryshme të E-mësimit që parashihet të zbatohen varësisht nga nivelet dhe shërbimet e ndryshme të arsimit parauniversitar. Përnga nivelet arsimore, e-mësimi do të organizohet në format në vijim:

1. **Edukimi në fëmijërinë e hershme - mësim në distancë:** materiale të ndryshme që publikohen në platformë të veçantë qoftë në televizion ose në internet. Edukatorët dhe prindërit do të shërbehen me këto video-materiale për realizimin e aktiviteteve të parapara në kurrikulë;
2. **Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (klasat 1-9) - mësim në distancë i kombinuar me mësim online.** Mësimi në distancë do të konsistojë në publikimin e video-materialeve (në përputhje të plotë me kurrikulën shtetrore) të përgatitura enkas nga mësimdhënësit dhe ekipet e ekspertëve. Ky mësim do të plotësohet nga mësuesit klasorë dhe mësimdhënësit lëndorë nëpërmjet të formave më ndërvepruese të mësimit online – në kohë reale – me nxënësit e vet në bazë të një orari të mësimit të dakorduar në nivel të shkollës (përmes Zoom, Google-meet, Microsoft teams etj). Mësimi në distancë mund të zbatohet edhe në rast se Qeveria e Republikës së Kosovës - MASH vendosin që të zhvillohet mësimi në shkolla.
3. **Arsimi i mesëm i ulët (klasat 1-9) me mësim në gjuhën serbe, turke, dhe boshnjake – mësim online (njësoj sikurse 2 më lartë)**
4. **Nxënësit e arsimit të mesëm të lartë (klasat 10-12 të përgjithshme dhe profesionale) – mësim online:** ndërveprim nëpërmjet të platformave në internet në kohë reale. Edhe në këtë nivel planifikohen të realizohen materiale të ndryshme virtuale dhe të përdoren platforma të gatshme (Zoom, Google Meet, Microsoft Teams etj) për të ndihmuar mësimfdhënësit në realizimin e mësimit online. Forma të caktuara të e-mësimit mund të zbatohen edhe nëse Qeveria – MASH vendosin që të zhvillohet mësimi në shkollë. Kjo mund të përdoret për konsultime, detyra shtëpie, vlerësim të nxënësve e të tjera.
5. **Fëmijët me nevoja të veçanta - mësim në distancë** - materiale për përkrahjen e mësimdhënësve, ndihmës-mësimdhënësve dhe mësimdhënësve mobil – për fëmijët e arsimit parauniversitar që kanë nevoja të veçanta arsimore. Për këtë qëllim do të avancohet platforma ekzistuese e realizuar gjatë zhvillimit të mësimit në distancë gjatë vitit shkollor 2019-2020.

Dokumenti është i organizuar në tri seksione të mëdha:

1. Pjesa e përgjithshme - projekti: në këtë pjesë paraqiten qëllimi, parimet, vlerat, objektivat dhe pakot punuese me aktivitetet kryesore të projektura për zbatimin e e-mësimit. Pjesa e përgjithshme vlenë për të gjitha nivelet, gjuhët dhe shërbimet njësoj (pos kur theksohet ndryshe në tekst). Projekti është i ndarë në katër komponenta kryesore (mësimi në distancë, mësimi online, mësimi praktik dhje mësimi në shkollë);
2. Plani i veprimit për zbatimin e e-mësimit: të projektuar në katër muaj punë për përgatitjen, realizimin, produksionin dhe transmetimin e video-materialeve (njësive) të e-mësimit.
3. Buxheti - vlerësimi i kostos së zbatimit të fillimit të vitit shkollor sipas skenarëve të MASH.

## QËLLIMI

Këtë vit shkollor Kosova zbaton qasjen e kombinuar në zhvillimin e procesit mësimor: mësimin në shkolla dhe e-mësimi. Mësimi në shkolla zhvillohet si zakonisht – por me përpjekje dhe kosto të shtuar të mirëmbajtjes e pastrimit. E-Mësimi në arsimin kosovar organizohet me qëllim që të ndihmohet ruajtja e mirëqenies shëndetësore të popullatës dhe për realizimin e kurrikulës shtetrore të arsimit në Republikën e Kosovës në kushte të pandemisë COVID – 19. Kjo qasje mundëson realizimin e objektivave kryesore të kurrikulës në kushte dhe si reagim i shoqërisë kosovare ndaj kërcënimeve të pandemisë. Në

këtë dokument trajtohen t]ë gjitha format e mësimit që do të aplikohen në nivelin e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (përfshirë edhe klasën parafillore dhe edukimin në fëmijërinë e hershme) në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe pjesërisht edhe në atë rome.

## PARIMET

Gjatë zbatimit të e-mësimit në arsimin kosovar, faktorët arsimorë të gjitha niveleve duhet t'u përmbahen parimeve ose kornizave të veprimit në vijim:

a) Kurrikula shtetrore: të gjitha format e mësimit duhet të jenë në funksion të realizimit të parimeve dhe qëllimeve kryesore të kurrikulës shtetrore të Kosovës;
b) E-mësimi në fazën e tanishme zbatohet për të lehtësuar realizimin e qëllimeve kurrikulare në rrethana të pandemisë COVID – 19. Me krijimin e kushteve normale, fëmijët do të vazhdojnë shkollimin në objektet shkollore. Forma të caktuara të e-mësimit do të aplikohen edhe pas kthimit në objekte shkollore.
c) Transparenca dhe qartësia: të gjithë faktorët arsimor në Kosovë, përfshirë mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit, duhet ta jenë të informuar plotësisht dhe në kohë të duhur për të gjitha veprimet që ndërmerren për zbatimin e e-mësimit në arsimin kosovar;
d) Pjesëmarrja aktive: të gjithë faktorët arsimorë kanë të drejtë dhe obligim të jenë pjesëmarrës aktivë të zbatimit të mësimit;
e) Krijimi i kushteve: autoritetet arsimore të të gjitha niveleve obligohen të krijojnë kushte që secili fëmijë dhe i ri të mund të përfitojë nga shërbimet e shkollimit;
f) Të nxënit atraktiv: memnaxhmenti i shkollave dhe mësimdhënësit do të ndërmarrin të gjitha masat që të krijojnë kushte të të nxënit atraktiv për të lehtësuar dhe shtuar pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitetet mësimore gjatë pandemisë (si në shkollë dhe në e-mësim).

## VLERAT

Vlerat krysore që i japin forcë dhe qëndrueshmëri zbatimit të vitit shkollor në Kosovë në kushte të pandemisë janë:

g) Gjithëpërfshirja: të gjithë fmijët në Kosovë duhet të përfitojnë nga shërbime sa më cilësore arsimore – edhe në kushte të pandemisë;
h) Qasja afirmative: autoritetet arsimore dhe puntorët arsimorë në Kosovë do të ndërmarrin veprimet e duhura për të krijuar kushte të barabarta për të gjithë fëmijët në Kosovë pa marrë para sysh përkatësinë etnike apo statusin ekonomik e social;
i) Mirëqenia (fizike dhe psikike) e fëmijëve – do të jetë përparësi e të gjitha veprimeve të autoriteteve arsimore në Kosovë gjatë zbatimit të mësimit në shkollë dhe e-mësimit në Kosovë.

## OBJEKTIVAT:

Objektivat kryesore të organizimit të mësimit në gjatë vitit 2020-2021 në kushte të pandemisë në Kosovë janë që:

1. Të organizohet mësimi (në shkollë, në distancë ose online) për ato nivele dhe grupe që përfitojnë më shumë nga format përkatëse të mësimit.
2. Të krijohen kushte për realizimin e video-materialeve për mësimin në distancë

3. Të rriten kapacitetet e mësimdhënësve për realizimin e mësimit në distancë dhe të mësimit online;
4. Të krijohen kushtet për zhvillimin e mësimit në shkolla për punë në kushte të pandemisë.
5. Të ofrohen kushtet teknike e teknologjike për të siguruar pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në të gjitha format e mësimit;

## PAKOT PUNUESE

Aktivitetet e nevojshme për arritjen e objektivave janë grupuar në katër komponenta dhe në pesëmbëdhjetë pako punuese.

### I. Komponenta e mësimit në distancë

#### 1. Koncepti i eMësimit dhe informimi

MASH do të koordinojë hartimin e konceptit dhe projektit të eMësimit për zbatim në Kosovë për vitin shkollor 2020-2021. Projekti përmban të gjitha elementet e nevojshme për zbatimin e suksesshem të eMësimit në shkollat e Kosovës, përfshirë konceptet kryesore, objektivat, aktivitetet, resurset e kuantifikuara, kostimin e aktiviteteve, planin e veprimit dhe buxhetin e detajuar. Do të hartohen koncepte të veçanta për tri nivelet arsimore parauniversitare (përfshirë komunitetet), për edukimin në fëmijërinë e hershme, për fëmijët me nevoja të veçanta dhe për arsimin profesional. Në këtë dokument përfshihen nivelt dhe shërbimet që do të përfitojnë nga mësimi në distancë (shoqëruar nga mësimi online).

**Aktivitetet:**

1.1. Krijimi grupit dhe identifikimi i personave përgjegjës për nivele
1.2. Hartimi /miratimi i koncepteve dhe projekteve për nivelet përkatëse
1.3. Hartimi dhe shpërndarja e materialeve për informim
1.4. Organizimi i procesit të informimit.

#### 2. Hartimi i vendimeve dhe udhëzuesve përkatës

Varësisht nga alternativat për të cilat përcaktohet MASH dhe grupet e ekspertëve, do të hartohen vendimet përkatëse, udhëzuesit, dokumentacioni pedagogjik e të tjera. Dokumentet do të miratohen nga MASH.

Aktivitetet

2.1. Caktimi i personave përgjegjës për hartimin e dokumenteve
2.2. Hartimi dhe miratimi i dokumenteve
2.3. Publikimi dhe shpërndarja e dokumenteve
**2.4.** Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit.

#### 3. Hartimi i kurrikulës dhe orarit

Divizioni i MASH për kurrikula, në bashkëpunim me DKA në Komunën e Prishtinës dhe me ekspertët e Institutit Pedagogjik të Kosovës do të bëjnë përshtatjen dhe përzgjedhjen e njësive mësimore me qëllim të standardizimit të renditjes së tyre për produksion dhe transmetim në mësimin online për tërë Kosovën. Në bazë të njësive të përzgjedhura do të hartohet edhe orari i produksionit, transmetimit dhe mësimit nëpër shkolla.

Aktivitetet

3.1. Caktimi i personave përgjegjës
3.2. Hartimi / miratimi i njësive dhe orarit për semestrin e parë
3.3. Hartimi / miratimi i njësive dhe orarit për semestrin e dytë
3.4. Rishikimi I kalendarit shkollor
**3.5.** Publikimi dhe shpërndarja e kalendarit për vitin shkollor dhe e orarit të mësimit

4. Përzgjedhja dhe aftësimi i mësimdhënësve për mësimin në distancë

MASH do të koordinojë identifikimin dhe rekrutimin e mësimdhënësve që do të marrin pjesë në përgatitjen dhe incizimin e video-materialeve për mësimin në distancë. Kjo do të realizohet duke përzgjedhur mësimdhënësit më të suksesshëm nga faza e parë e zbatimit të mësimit në distancë (mars – qershor 2020) dhe duke bërë thirrje për shprehje të interesimit nga mësimdhënës të tjerë. Informimi do të bëhet nëpërmjet të mediave elektronike dhe rrjeteve sociale, ndërsa përzgjedhja do të bëhet përmes shqyrtimit të incizimeve të arritura, hartimit të listës së shkurtë dhe intervistimit të një numri të nevojshëm të kandidatëve. Kandidatët e përzgjedhur do të aftësohen për përgatitje, prezanrtim dhe xhirim të video-materialeve. Pos mësimdhënësve, do të përzgjedhen edhe një numër i auditorëve dhe redaktorëve. 104 mësimdhënës, 54 redaktorë dhe 18 auditorë do të aftësohen me një program tre-ditor në fushën e metodologjisë/përmbajtjes, teknologjisë/dizajnit, dhe shkathtësive të prezantimit. Aftësimin do ta bëjnë mësimdhënësit e fazës së parë, ekipi i produksionit dhe ekspertët e MASH.

**Aktivitetet:**

4.1. Përzgjedhja e mësimdhënësve më të suksesshëm nga faza e parë
4.2. Shpallja e thirrjes për mësimdhënës për mësimin në distancë për 2020-2021
4.3. Përzgjedhja e numrit të mjaftueshëm të mësimdhënësve, auditorëve dhe redaktorëve (MAR)
4.4. Hartimi i programit të aftësimit për MAR
4.5. Hartimi dhe shtypja e doracakëve për zbatim të programit
4.6. Aftësimi i mësimdhënësve, auditorëve dhe redaktorëve (MAR) të përzgjedhur.
**4.7.** Organizimi I monitorimit dhe mbikëqyrjes

5. Sigurimi dhe organizimi i produksionit (Shkollat Qamil Batalli dhe Emin Duraku & Gracanice)

MASH do ta bëjë vlerësimin e nevojave për sigurimin e kushteve të punës, përfshirë pajisjet teknike / teknologjike për realizimin e orëve mësimore, incizimin dhe produksionin e video-materialeve për mësimin në distancë. Pajisjet do të vendosen në SHMU "Qamil Batalli" në Prishtinë dhe në SHFMU "Emin Duraku" Prizren. Do të angazhohet një kompani ose personel për produksion/post-produksion të video-materialeve.

**Aktivitetet:**

5.1. Vlerësimi i nevojave
5.2. Furnizimi me pajisje teknike-teknologjike dhe materiale për mbrojtje shëndetësore në sheshxhirim
5.3. Organizimi i shërbimit të përkrahjes teknike dhe logjistike

5.4. Kontraktimi i shërbimeve logjistike (mbrojtje, sigurim, ushqim, transport, komunikim e të tjera).
5.5. Sigurimi I shërbimeve të produksionit / post-produksionit.

6. Zbatimi i mësimit në distancë - xhirimi i emisioneve

Mësimdhënësit do të organizohen në grupe punuese sipas niveleve arsimore / klasave / lëndëve. Anëtarët e grupit do të punojnë për përgatitje të materialit dhe dizajnim të orës. Pas dizajnimit, materiali do t'i dërgohet redaktorit për vlerësim dhe përmirësim të materialeve. Redaktorët ndahen në tri grupe: vlerësim përmbajtësor, metodologjik dhe gjuhësor. Secili redaktor mbanë përgjegjësi për pjesën e vet. Pas rregullimit të materialit nga ana e redaktorit, bëhet realizimi dhe incizimi i orës përmes Zoom / platformës përkatëse. Ora e realizuar dhe video-materiali dergohen të redaktori final. Pas këtij miratimi, materiali dërgohet për lejim të publikimit nga koordinatori i eMesimit, ose personi i caktuar nga ai/ajo.

**Aktivitetet:**

6.1. Përgatitja e orës dhe materialeve mësimore
6.2. Redaktimi dhe auditimi
6.3. Realizimi i orës dhe incizimi në zoom
6.4. Redaktimi përfundimtar
6.5. Miratimi i video-materialeve

7. Produksioni dhe transmetimi

Pas realizimit, redaktimit dhe xhirimit të video-materialeve, ato përcillen te ekipi i produksionit dhe post produksionit për përshtatje dhe përgatitje për transmetim në platforma online ose në televizion. Ekipi i produksionit do të ndihmojë edhe xhirimin e video-materialeve (për më shumë shih Planin për zbatimin e e-mësimit në klasat 1-9).

**Aktivitetet:**

7.1. Përcjellja e video-materialeve te produksioni
7.2. Përmirësimi / përshtatja e materialeve sipas nevojës
7.3. Përgatitja teknike e video-materialit për transmetim dhe publikim
7.4. Përcjellja e materialit për transmetim / publikim sipas orarit të miratuar.

8. Monitorimi dhe vlerësimi

MASH do të krijojë një grup për monitorim të rregullt të e-mësimit në Kosovë. Grupi monitorues përbëhet nga personeli i MASH, Inspektorati Arsimor, dhe personeli i DKA-ve. Për lehtpsim të monitorimit do të angazhohet një grup ekspertësh për hartimin e indikatorëve dhe të Kornizës së Monitorimit. Të dhënat e siguruara nga monitorimi do të përdoren për vlerësimin periodik dhe (eventualisht vjetor) të zbatimit të e-mësimit. Raportet e vlerësimit do të hartohen nga Instituti Pedagogjik i Kosovës.

**Aktivitetet:**

8.1. Krijimi i grupit për monitorim (hulumtim) sipas niveleve

8.2. Krijimi i strukturës dhe përotokolit për monitorim (struktura arsimore)
8.3. Hartimi i indikatorëve
8.4. Hartimi i kornizës së monitorimit
8.5. Hartimi i raporteve nga koordinatorët për nivele
8.6. Hartimi i raportit për eMësimin.

9. Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (EHF) – edukimi në distancë

Edukimin në Distancë për nivelin e edukimit në fëmijërinë e hershme,mosha 0-6 vjeç, MASH-, do ta oranizoj përmes platforms online tashmë të krijuar me ndihmën e Partnerëve si UNICEF-i dhe Save the Children e cila u lancua me datë 15 prill 2020, në përgjigjie të situates së krijuar me Covid 19'. Platforma Edukimi në Distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç, u krijua që t'u jemi pranë prindërve\kujdestarëve ligjor dhe edukatoreve në realizimin e aktiviteteve ditore me fëmijët në kushte shtëpjie. Përmbajtja e aktiviteteve të prezantuara në këtë Platformë, stimulon fëmijët në zhvillimin e tyre në të gjitha fushat zhvillimore në varësi të moshës së tyre si në Shëndetin fizik dhe zhvillimi lëvizor, Zhvillimi i gjuhës dhe komunikimit, Zhvillimi emocional dhe social, Zhvillimi njohës dhe njohuritë e përgjithshme,dhe Qasjes ndaj të mësuarit . Për prindërit dhe edukatoret, kjo platformë do të ofroj një strukturë të oganizuar të përmbajtjes edukative,organizuar në tema mujore,javore dhe aktivitete ditore, të zbërthyera për prindërit dhe edukatoret në baza ditore. Përmbajtja e platformës "Edukimi në Distancë'do të jetë në shërbim për të gjithë fëmijët e moshës 0-6 vjeç pa dallim, pra edhe për fëmijët të cilët nuk janë pjesë e institucioneve parashkollore por edhe për fëmijët e komunitetit jo shumicë duke pasur parasysh që përmbajtja edukative, do të hartohet dhe prezantohet edhe në gjuhët e komunitetit. Linku i Platformës edukimihershem-rks.net.

Aktivitetet për zbatimin e platformës 'edukimi në distance"

9.1. Krijimi i grupit punues me vendim, për hartimin e temave mujore\javore dhe aktiviteteve ditore
9.2. Hartimi i temave mujore\javore dhe zbërthimi në aktiviteteve ditore për prindërit dhe edukatoret
9.3. Redaktimi dhe lektorimi i materialeve edukative
9.4. Zhvillimi i audio-videove për transmetim në RTK (Aktivitetet ditore për të gjitha moshat e edukimit në fëmijërinë e hershme)
9.5. Fushatë vetëdijësuese për rëndësinë e edukimit në distancë – implementimi i platformës (realizohen 4 fushata brenda vitit)
9.6. Trajnim online i edukatoreve për përdorimin e platformës dhe bashkëpunimi me prindërit
9.7. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e Platformës,(zhvillimi i formës për raportimin nga edukatoret formati word dhe digjital, krijimin e databazës digjitale, perpilimi i hartës se kopshteve publike dhe private te licencuara ne nivel vendi dhe mirëmbajtja e faqes së FB-së)
9.8. Përkthimi i materialeve edukative në gjuhët Serbe,Turke dhe Rome dhe Boshnjake
9.9. Formohet grupi punues dhe hartohet plani i veprimit për Monitorimin e zbatimit të platformës "Edukimi në Distancë"

10. Arsimi për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore – mësimi në distancë

10a) Mirëmbajtja dhe popullimi i platformës arsimigjithperfshiers.net për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore

Arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në kushte normale është proces kompleks dhe kërkon resurse njerëzore të specializuara dhe materiale adekuate që të përgjigjen nevojave individuale të fëmijëve pasi që qasja puna është tërësisht e individualizuar. Këtij kompleksiteti i shtohet edhe vështirësia e mësimit në distancë pasi që kërkon ndër të tjera shkathtësi digjitale nga ana e mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve.

Duke pasur parasysh specifikat e nxënësve me nevoja të veçanta pamundësisë që shumica e tyre të vijojnë mësimin në distancë përmes televizionit apo operatoreve tjerë për shkak të aftësisë se kufizuar dhe shkalles se dëmtimeve që kanë MASH do të vazhdojë të punojë në pasurimin, avancimin dhe mirëmbajtjen e Platformës " arsimigjithëpëfshires.net". Aktualsiht për shkak të situatës emergjente që ishim nuk kemi pasur mundësi të bëjmë dizajnimin dhe azhurnimin e aktiviteteve mësimore dhe materialeve sipas llojeve të aftësisë se kufizuar dhe nevojave kështu që mbetet akoma punë për tu bere në avancimin e platformës dhe popullimin e saj me aktivitete mësimore, materiale didaktike, këshilla, video, udhëzime audio-vizuale, fleta pune dhe fotografi për të gjithë fëmijët bazuar në nivelet dhe aftësitë individuale. Organizata Save the Children do të mirëmbajë platforme nder në 15 dhjetor 2020 dhe me pas platforma duhet të mirëmbahet dhe menaxhohet nga MASh.

**Aktivitetet**

10.1 Zhvillimi i funksioneve dhe moduleve ekzistuese për webfaqe

10.2 Trajnime rreth moduleve, instruksione për ndryshime në publikime, ndryshime të materialeve reprezentative

10.3 Mirëmbajtja e platformës

10.b) Trajnimi i mësimdhënësve që punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta për përdorim të teknologjisë në mësimdhënie

Situata në të cilën gjendemi ka thelluar edhe me shumë pabarazitë mes fëmijëve sidomos atyre që vijnë nga grupet e margjinlazuara. Andaj parësore është krijimi i mundësive të barabarta për t'i trajtuar dallimet e nxënësve në mënyre që të japim mundësi secili fëmijë të përfshihet procesin e mësimnxënies duke kontribuar që çdo fëmije\nxënësi t'i ofrohet mundësia që të shpalosë vlerat individuale, të ndjehet i pranuar, i vlerësuar dhe të përftojë maksimalisht nga procesi mësimor. Arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta edhe në kushte normale është kompleks dhe kërkon të përdoren çasje dhe forma të ndryshme të punës në mënyrë që t'u jepet mundësia fëmijëve me nevoja të veçanta të demonstrojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre. Këtij kompleksiteti i shtohet edhe vështirësia e mësimit në distancë pasi që kërkon ndër të tjera shkathtësi digjitale. Andaj për të tejkaluar ketë sfide duhet të behet ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie me fokus të platformat të cilat do të përdoren për realizimin e mësimit në distancë. Në trajnim do të përfshihen 320 mësimdhënës, mësimdhënës të qendrave burimore, mësimdhënës mbështetës dhe asistentë që punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta

**Aktivitetet**

- Hartimi i programit të trajnimit
- Identifikimi i trajnerëve
- Kontraktimi i trajnerëve
- Organizimi i trajnimit online 2 ditor

## II. Komponenta e mësimit online

Në kushte të pandemisë Covid-19 pjesa më e madhe e aktiviteteve të e-mësimit në të gjitha nivelet arsimore do të zhvillohet në formë të mësimit online – ashtu që mësimdhënësit do të komunikojnë me nxënësit e vet nëpërmjet të platformave të mësimit online si Zoom, Google Meet, Google Classroom, Microsoft Teams e të tjera. Kjo formë e mësimit mundëson komunikimin e drejtëpërdrejtë të mësimdhënësve me nxënës – gjithnjë në kuadër të një orari të caktuar nga drejtoria e shkollës ose nga drejtoria komunale e arsimit. Mësimi online do të zhvillohet në të gjitha gjuhët mësimore në Kosovë dhe do të përfshijë:

- nxënësit e shkollave të mesme të larta (klasat 10-12) si forma kryesore e të mësuarit (MASH ka përgatitur një elaborat për zhvillimin e mësimit online);
- nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta (1-5 dhe 6-9) si formë përcjellëse e mësimit në distancë;
- aplikimi i formave të mësimit online nga edukatorët në EFH dhe nga mësimdhënësit e ANV.

Për realizimin e mësimit online kërkohen tri premisa themelore:

a) një platformë e mësimit online
b) mësimdhënësit e aftësuar për përdorimin e platformave dhe teknologjive të reja në mësimdhënie;
c) pajisje të mjaftueshme teknologjike për përdorim nga mësimdhënësit dhe fëmijët.

## 11. Platforma e mësimit online:

MASH ka trashëguar një sistem të papërfunduar të mësimit të digjitalizuar në nivel qendror. Janë bërë përpjekje për vendosjen e platformës së Microsoft Office si platformë qendrore në nivel nacional që do të mundësonte mësimin e digjitalizuar. Një gjë e tillë është realizuar në një masë në arsimin profesional (me aftësim të mësimdhënësve dhe me qasje në platformë). Megjithëkëtë, është dëshmuar se platforma nuk është gati për zbatim në masë të e-mësimit me të gjithë nxënësit në Kosovë. Për këtë arsye, në fazën e tanishme shkollat do të përdorin platformat elektronike ndërkombëtare që janë në dispozicion gratis si: Zoom, Google Meet, Google Classroom, Micrsoft Teams, Viber e të tjera. Këto platforma do të përdoren derisa MASH të vendosë dhe të zbatojë strategjinë e vet për digjitalizimin e arsimit.

MASH do të angazhohet gjatë këtij viti shkollor, që të sigurojë edhe një platformë qendrore nëse ekzistojnë kushtet e duhura për këtë. Në ve]anti, mund të përdoren platforma për menaxhimin e mësimit në distancë/online dhe për produksion të videomaterialeve. Kostoja e vlerësuar e kësaj mase është rreth 2,6 milionë euro. Kjo masë do të realizohet me vëmendje të ve]antë për të mbrojtur interesat e MASH, për të siguruar transparencë, pronësisë së MASH mbi procesin dhe mbi produktin dhe pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes për shkak të rëndësisë së platformës. MASH do t]ë

ndërlidhë ]ështjen e Platformës edhe me Strategjinë e digjitalizimit që pritet të fillojë të hartohet nga tetori 2020.

12. Aftësimi i mësimdhënësve:

Zbatimi i mësimit online në fazën e parë (mars – qershor 2020) ka treguar për mangësi të konsiderueshme dhe improvizime në zbatimin e mësimit online për shkak të mungesës së shkathtësive të mësimdhënësve për përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënie. Për këtë arsye kërkohet një program masovik i aftësimit të mësimdhënësve për zbatimin e mësimit online. Donatorë të shumtë kanë ofruar mbështetje në këtë drejtim. Pritet përkrahje e madhe nga UNICEF, GIZ, Banka Botërore, SDC-ja zvicerane, e nga donatorë të tjerë për këtë qëllim. Të gjtihë këta donatorë tashmë kanë krijuar kapacitete dhe programe aftësimi që mund të aktivizohen me kërkesë të MASH. Shpenzimet për aftësimin e mësimdhënësve mund të mbulohen nga MASH dhe nga donatorët. Krahas aftësimit është me rëndësi që të veendoset një mekanbizëm për përkrahje të mësimdhënësve në nivel nacional, komunal dhe institucional. Kjo përkrahje mund të realizohet në formë të help-desk në të gjitha nivelet.

**Aktivitetet:**

a. Identifikimi/hartimi i programeve të aftësimit
b. Identifikimi dhe aftësimi i trajnerëve të ardhshëm
c. Identifikimi dhe aftësimi i mësimdhënësve për help-desk
d. Zbatimi i programit të aftësimit
e. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të shkathtësive të fituara.

13. Sigurimi i pajisjeve teknologjike për zhvillimin e mësimit online

Gjatë zbatimit të mësimit online në fazën e parë (mars – qershor 2020) është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i nxënësve në Kosovë nuk kanë pasur mundësi të vijojnë mësimin për shkak të mungesës së kushteve – pajisjeve teknologjike (lap-top, kompjutor personal, tablet, iPad, telefon i menqur, televizor e të tjera). Këto kanë qenë kryesisht fëmijët nga familjet në asistencë sociale, mirëpo ka pasur edhe raste që familjet thjeshtë kanë qenë të papërgatitura për këtë formë mësimi. Familjet, MASH, DKA-të, donatorët dhe komuniteti[1] kanë bërë përpjekje të shumta për tejkalimin e kësaj situate gjatë fazës së parë, mirëpo, prapë mendohet se rreth katër (4)[2] përqind e nxënësve në sistemin arsimor të Kosovës ende nuk kanë mundësi për përcjelljen e mësimit online ose të mësimit në distancë. Katër përqind e nxënësve në arsimin kosovar nënkuptojnë rreth 14,000 nxënës; nëse një njësi - pajisje teknologjike vlerësohet me rreth 200 euro, artëherë kërkesat janënë vlerë prej rreth 2.8 milion për të siguruar minimumin e kushteve për e-mësim. Kur kësaj shume i zbritet vlera e investimeve dhe alokimeve tashmë të bëra nga MASH, GIZ dhe BB (rreth 1.700,000 euro), që pritet të konkretizohen deri në fillim të vitit shkollor, mbeten 1.1 milion euro që duhen mobilizuar nga Qeveria e Kosovës (dhe donatorëve) për realizim e-mësimit në vitin shkollor 2020-2021.

**Aktivitetet:**

[1] Gjatë vitit 2020: GIZ – CBDE ka investuar rreth 500,000 euro në pajisje për 20 shkolla; Banka Botërore ka investuar rreth 500,000 euro në teknologji të reja; dy kompani private (ELKOS dhe Lazim Destani) kanë ndihmuar me rreth 900 pajisje; DKA-të kanë mobilizuar mjete të konsiderueshme; MASH ka alokuar 770,000 euro për pajisje teknologjike për vitin shkollor 2020-2021.

[2] Vlerësimet e MASH dhe të organizatave të ndryshme lëvizin prej 3-5 % të numrit të nxënësve që nuk kanë mundësi të vijojnë mësimin për mungesë të kushteve.

- Vlerësimi i nevojave (lista emërore e fëmijëve që kanë nevojë për pajisje - nga DKA-të)
- Blerja e pajisjeve teknologjike
- Shpërndarja
- Monitorimi i përdorimit të pajisjeve.

### 13.a. Shkolla - qendër burimore për e-mësimin

Një pjesë e madhe e mësimdhënësve, pos mungesës së shkathtësive për përdorim të teknologjive të reja për mësimdhënie, kanë pasur edhe mungesa të theksuara të pajisjeve teknolgjike.

- Për këtë qëllim kërkohet krijimi i kushteve të punës në shkollat përkatëse. Katër deri pesë klasa do të shndërrohen në kabinete të mësimdhënësve (sipas nevojës do të përdoren edhe për nxën]ësit që nuk kanë pajijse teknologjike ose kushte për punë në shtëpi).
- Pos kësaj, në secilën komunë do të përdoret një shkollë (në komunat e mëdha dy deri tri të tilla) ose Qendra Didaktike **si qendër burimore.** Sallat e leximit të bibliotekave ose kabineti i informatikës ose një dhomë mësimi do të furnizohet me një numër prej 6-8 kabinash me pajisje të duhura teknologjike. Klasa do të ketë edhe një smart board për poërgatitjen e materialeve për mësimin online. Gjatë orarit të mësimit, secila shkollë do të ofrojë shërbim përkrahës (IT) për mësimdhënësit për disenjimin e materialeve mësimore dhe për metodologji të mësimdhënies online (koordinatori për cilësi ose mësimdhënës tjetër). Në rastet kur shkollat nuk kanë kompjuterë dhe pajisje cilësore, DKA dhe MASH obligohen të sigurojnë pajisjet e duhura (nga mjetet e siguruara për pajisje teknologjike për nxënës – 13.2).

Aktivitetet:

13.1. Hartimi i programit të qendrave burimore për e-mësim
13.2. Vlerësimi i nevojave për realizim të programit
13.3. Krijimi i kabineteve për mësimdhënës
13.4. Realizimi i aftësimit të përkrahjes (metodologjike, gjuhësore dhe teknologjike)
13.5. Vlersëimi i funksionimit të programit të qendrave burimore.

### 13b) Sigurimi i platformave për menaxhimin e zhvillimit online dhe në distancë

Gjatë fazës së parë të zbatimit të mësimit në distancë, drejtoritë komunale të arsimit e panë të domosdoshme krijimin e platformave elektronike përmes të cilave të monitorohet dhe përkrahet puna e mësimdhënësve dhe shkollave. MASH sot nuk ka një platformë të tillë në nivel qendror, si] e kanë shumica e vendeve në Evropë. Kjo platformë pritet të krijohet në planin afatmesëm, në kuadër të zbatimit të strategjisë së digjitalizimit të arsimit që pritet të hartohet duke filluar nga shtatori i këtij viti. Në ndërkohë, drejtoritë komunale të arsimit duhet të identifikojnë dhe disenjojnë platforma ose aplikacione të ndryshme për menaxhimin e procesit mësimor online e në distancë. Kjo kërkon mjete të konsiderueshme, të cilat nuk kanë qenë të parapara në mënyrë specifike në grantet komunale për vitin 2020. Disa komuna kanë bërë rialokime të mjeteve për këtë qëllim (si për shembull Komuna e Prishtinës). Të tjera janë në pritje të një platforme nacionale ose të përkrahjes nga MASH / Qeveria.

Kostoja e përaftërt për menaxhimin e një platforme të tillë vlerësohet në rreth 2.6 milion euro. Në rastin e arsimit profesional janë duke u zhvilluar negociata që këto shërbime të ofrohen nga donatorë të jashtëm të lidhur me ofrues vendor. Pritet që komunat të mbulojnë një pjesë të këtyre shpenzimeve duke rialokuar mjete buxhetore në kuadër të buxhetit të vet. Megjithëkëtë, kërkohet sigurimi i përkrahjes për komunat për këtë qëllim.

## III. Komponenta e punës praktike

### 14. Planifikimi dhe zbatimi i punës praktike dhe i praktikës profesionale

Gjatë fazës së parë të realizimit të e-mësimit më së shumti janë dëmtuar shkollat profesionale, të cilat nuk kanë qenë në gjendje të kryejnë si duhet lëndët profesionale dhe komponentën praktike të mësimit (qoftë në shkollçë apo në ndërmarrje). Për këtë arsye, gjatë e-mësimit do të mundësohet kryerja e punës praktike në shkollë ose në ndërmarrje. Shkollat dhe DKA-të dot ë kujdesen që të krijohen kushtet për realizim të praktikës profesioanle dhe për mbrojtjen e shëndetit të nxënësve e mësimdhënësve në përputhje me udhëzimet e IKSHPK. Puna praktike dhe praktika profesionale do të zhvillohen në laboratore, në punëtori dhe në ndërmarrje. Sa herë që kjo të jetë e mundur, shkollat dhe DKA do të mundësojnë mësimin e punës praktike duke aplikuar laboratorë virtualë dhe aktivitete virtuale të punës. MASH dhe donatorët do të ndohmojnë shkollat për sigurimin e burimeve online për këtë qëllim.

Për realizimin e kësaj komponente do të përdoren mjetet financiare nga grantet specifike të komunave për arsim.

**Aktivitetet:**

- Planifikimi i punës praktike në shkollë
- Planifikimi i praktikës profesionale në ndërmarrje
- Zbatimi i punës praktike
- Monitorimi dhe vlerësimi i punës praktike

## IV. Komponenta e zhvillimit të mësimit në shkollë

### 15. Zbatimi i mësimit nëpër shkolla

Në kuadër të politikës së vet për mësimin e kombinuar dhe në përputhje me rekomandimet e IKSHPK, praktikave të mira nga vendet e tjera dhe analizave të veta, MASH planifikon zhvillimin e mësimit me një pjesë të nxënësve / shkollave / viteve të shkollimit nëpër objektet shkollore. Për realizimin e kësaj komponente nuk kërkohen mjete shtesë në aftësim, ose teknologji, por kërkohen shpenzime shtesë në **mësimdhënie** (për shkak të përgjysmimit të klasave dhe rritjes së vëllimit të punës dhe për të zëvendësuar msimdhënësit me gjendje të rëndë shëndetësore që nuk guxojnë të ekspozohen ndaj infekstimit - në shumë prej rreth 3.6 milionë euro), pastrim, mirëmbajtje, dezinfektim (në shumë prej rreth 2.6 milion euro – shih buxhetin). Pos këtyre pozicioneve të mëdha krijohen edhe shpenzime të tjera më të vogla.

Një efekt tjetër i rritjes së kërkesave për mirëmbajtje është edhe rritja e vëllimit të punës së punëtorëve të **mirëmbajtjes** nëpër shkolla, ve]anërisht nëpër zonat më të ngarkuara urbane. Për këtë arsye është vlerësuar se do të ketë rritje të vëllimit të punës në mirëmbajtje prej së paku 100 normave të punëtorëve teknik / të mirëmbajtjes.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i pandemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19 është edhe gjendja psikike e fëmijëve dhe familjeve, sidomos gjatë periudhave të mbylljes në shtëpi. Sot, sistemi arsimor në Kosovë nuk ka numër as për së afërmi të mjaftueshëm për trajtimin e këtij aspekti të rëndësishëm të shërbimeve arsimore në Kosovë. Për këtë arsye, kërkohet krijimi i kushteve për sigurimin e prëkrahjes në shërbiume psikologjike dhe pedagogjike (në masë prej rreth 100 **psikologëve** dhe i 50 pedagogëve)

për identifikimin e problemeve psikologjike të shkaktuara nga pandemia te nxënësit e te mësimdhënësit dhe për ofrimin e shërbimeve këshilluese arsimore.

